



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Në bazë të nenit 28 paragrafi 1.1, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Ligji nr. 03/L-229, (Gazeta zyrtare nr. 88, dt. 25.11.2010) si dhe neni 4 dhe 7A, paragrafi 2 i Plotësim Ndryshimit të Ligjit 04/L-226, Komisioni i Autoriteti Kosovar I Konkurrencës me **dt. 21.11.2017** nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 04/2017

PËR PËRJASHTIMET GRUPORE TË MARRËVESHJEVE NË SEKTORIN E

TRANSPORTIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

1. Ky Udhëzim Administrativ (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi) përcakton kushtet që marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve të cilat rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor duhet t'i përmbajnë, si dhe kufizimet ose kushtet që marrëveshjet e tilla nuk mund t'i përmbajnë në mënyrë që të jenë të përjashtuara në grup nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4, të Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejme: ndryshim plotësimi i Ligjit).
2. Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve që rregullojnë transportin ajror nuk mund të përjashtohen në grup në kuptim të këtij Udhëzimi, por mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4, të ndryshim plotësimi të Ligjit dhe nëse në mënyrë kumulative gjatë kohëzgjatjes së tyre i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4, të ndryshim plotësimi të Ligjit.

Përkufizimet

Neni 2

Në këtë Udhëzim Administrative termet e mëposhtme kanë këto kuptime

- a) *Marrëveshje* - është një kontratë, një dispozitë e kontratës, marrëveshje gojore apo me shkrim ndërmjet ndërmarrësve dhe praktikave të bashkërenduara që rezultojnë nga marrëveshje të tilla, vendimet nga ndërmarrësit ose grupimet e ndërmarrësve, kushteve të përgjithshme të biznesit dhe akteve tjera të ndërmarrësve që janë ose mund të jenë pjesë e

kontratës dhe të ngjashme, pavarësisht nga/nëse një marrëveshje e tillë në mes të dy ose më shumë ndërmarrësve të pavarur që veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose të shpërndarjes (marrëveshjet horizontale) ose në mes të dy e më shumë ndërmarrësve të pavarur që nuk operojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose të shpërndarjes (marrëveshjet vertikale),

- b) *Produkte* - janë mallra dhe/ose shërbime që përfshijnë gjysmëfabrikatet e mallrave dhe/ose shërbimeve dhe të mallrave dhe/ose shërbimeve të përfunduara,
- c) *Ndërmarrje* - çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist,
- d) *Tregu relevant* - fushën e tregtisë për të cilën konkurrenca është kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat konsumatorët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezulton në ngritjen e çmimit.

II. MARRËVESHJET NË TRANSPORTIN RRUGOR DHE HEKURUDHOR

Neni 3

Marrëveshjet për të cilat zbatohet përjashtimi grupor

1. Përjashtimi grupor zbatohet për marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor sipas nenin 7A, paragrafi 3 të ndryshim plotësimit të Ligjit, marrëveshjet e lidhura në mes të dy ose më shumë ndërmarrësve të pavarur, të cilët për qëllim kanë zbatimin dhe përmirësimin teknik ose vendosjen e bashkëpunimit teknik nëpërmjet:
 - a. Standardizimit të pajisjeve, furnizimeve, mjeteve të transportit ose instalimeve fikse,
 - b. Shkëmbimit ose bashkimit me qëllim të operimit të shërbimeve të transportit, të stafit, të paisjeve, të automjeteve ose të instalimeve fikse,
 - c. Organizimit dhe ekzekutimit të njëpasnjëshëm, plotësues, zëvendësues apo transport të kombinuar, si dhe përcaktimin dhe aplikimin e tarifave dhe kushteve për shërbime të tilla të transportit, duke përfshirë edhe tarifat e veçanta konkurruese,
 - d. Përdorimit në rastin e shërbimeve të kryera nga një lloj transporti në rrugët me operim më racional,
 - e. Rregullimit të orareve për lidhëshmërinë rrugore,
 - f. Bashkimit të dërgesave individuale,
 - g. Vendosjes së rregullave unike mbi strukturën e tarifave dhe kushteve tjera për zbatimin e tyre, me kusht që me këto rregulla të mos përcaktohet tarifa e transportit dhe kushtet e transportit.
2. Përjashtimi grupor zbatohet edhe për marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor të cekura në nenin 7A, paragrafi 2, të ndryshim plotësimit të Ligjit, të lidhura në mes të dy ose më shumë ndërmarrësve të pavarur për qëllime të:
 - a. Krijimit dhe funksionimit të një shoqate të ndërmarrësve të angazhuar në transportin rrugor për të ofruar shërbime të transportit,

- b. Financimit të përbashkët apo blerjes së paisjeve të transportit ose furnizimeve, kur këto aktivitete janë direkt të lidhura me ofrimin e shërbimeve të transportit dhe kur janë të domosdoshme veprimet e përbashkëta të shoqatës së ndërmarrësve.
3. Pjesëmarrës në marrëveshje që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor konsiderohen ndërmarrësit nga Neni 3 paragrafi 1 i këtij neni dhe lidhëshmëria në mes tyre.

Neni 4

Kushtet që marrëveshja duhet t'i përmbajë dhe kushtet tjera që duhet t'i përmbushë

1. Përjashtimet grupore për marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor nga neni 3, paragrafi 2 i këtij Udhëzimi i nënshtrohen kushteve të mëposhtme:
 - a. Kapaciteti total i transportit të çfar do grupi nuk guxon të jetë më i madh se **10,000 ton** në rastin e transportit rrugor,
 - b. Kapaciteti individual i çdo ndërmarrësi i cili është anëtar i çfar do grupi nuk guxon të jetë më i madh se **1,000 ton** në rastin e transportit rrugor.

Neni 5

Kufizimet ose kushtet që marrëveshjet nuk guxojnë t'i përmbajnë

1. Përjashtimet grupore për marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor nga neni 3 i këtij Udhëzimi nuk zbatohen kur ato marrëveshje si qëllim ose pasojë kanë:
 - a. Përcaktimin e tarifave të transportit dhe kushteve që kufizojnë ose kontrollojnë ofertën e shërbimeve të transportit,
 - b. Ndarjen e tregut të transportit,
 - c. Aplikimin e përmirësimeve teknike ose të bashkëpunimit teknik,
 - d. Financimin e përbashkët apo blerjen e pajisjeve të transportit ose furnizimeve, ku këto aktivitete janë të lidhura direkt me ofrimin e shërbimeve të transportit dhe janë të nevojshme për drejtimin e përbashkët të ofrimit të shërbimeve nga ana e shoqatave të ndërmarrësve të cilët janë të angazhuar në transportin rrugor,
 - e. Abuzimin me pozitën dominuese në tregun e trafikut.
2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen gjithashtu për aktivitetet e shërbimeve ndihmëse në sektorin e transportit.

III. KUSHTET PËR REVOKIMIN E PËRJASHTIMEVE GRUPORE NË TË CILAT ZBATOHET KY UDHËZIM DHE BARRA E PROVËS

Neni 6

Kushtet për revokimin e përjashtimeve grupore

1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) mundet sipas detyrës zyrtare, në përputhje me nenin 7A të ndryshim plotësimit të Ligjit, të fillojë procedurën e vlerësimit të ndonjë marrëveshjeje që rregullon transportin rrugor dhe hekurudhor edhe pse marrëveshja është e kualifikuar si përjashtim grupor sipas këtij Udhëzimi, në rastin kur efektet e marrëveshjes individuale apo kumulative me marrëveshjet e ngjashme në tregun përkatës, nuk i përmbushin në mënyrë kumulative kushtet për përjashtim gjatë kohëzgjatjes

së tyre sipas nenit 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji bazik)

2. Nëse Autoriteti është në proces të vlerësimit të ndonjë marrëveshjeje sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe konstaton se marrëveshja ka efekte të cilat janë në kundërshtim me kushtet e specifikuar në nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit bazik dhe të këtij Udhëzimi, do të nxjerr Vendim që të revokoi përjashtimin grupor për atë marrëveshje.

Neni 7

Barra e provës mbi përmbushjen e kushteve për përjashtimet grupore

1. Për marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor, të cilat i përmbushin kushtet për përjashtim grupor nga ky Udhëzim, në parim nënkuptohet se i përmbushin kushtet e neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit bazik, përveç në rastet e nenit 6 të këtij Udhëzimi,
2. Përveç rasteve të marrëveshjeve nga paragrafi 1 të këtij neni të cilat nuk i përmbushin kushtet për përjashtim grupor sipas këtij Udhëzimi, pjesëmarrësit e marrëveshjeve të tilla duhet vetë të vlerësojnë nëse marrëveshjet e tyre i përmbushin kushtet për përjashtim nga ndalimi i përgjithshëm i marrëveshjeve të cekura në nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit bazik,
3. Nëse Autoriteti ka filluar procedurën e konstatimit të marrëveshjes së ndaluar sipas paragrafit 2 të këtij neni, barra e provës u takon ndërmarrësve pjesëmarrës se a i përmbushin kushtet për përjashtim sipas neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit bazik.

IV. MARRËVESHJET PËR TË CILAT NUK APLIKOHET KY UDHËZIM

Neni 8

Marrëveshjet në të cilat nuk aplikohet përjashtimi grupor

1. Bazuar në këtë Udhëzim nuk mund të përjashtohen nga ndalimet e përgjithshme sipas nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit bazik:
 - a. Marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor, të cilat nuk janë në përputhje me këtë Udhëzim,
 - b. Marrëveshjet që rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor në të cilat aplikohen dispozita tjera ekskluzive për përjashtime grupore nga neni 7A i ndryshim plotësimi të Ligjit,
 - c. Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve që rregullojnë transportin ajror.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

1. Në Marrëveshjet e transportit rrugor dhe hekurudhor të cilat janë të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ dhe të cilët i kanë plotësuar kushtet për përjashtim grupor nga neni 4 paragrafi 3 të ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 do të vazhdojnë të zbatohen dispozitat e ligjit të përmendur.

2. Marrëveshjet e transportit rrugore dhe hekurudhore për përjashtimet grupore ndërmjet ndërmarrësve duhet të harmonizohen plotësisht me dispozitat e këtij U.A.
3. Hasja në vështirësi gjatë aplikimit të dispozitave të kësaj U.A apo mungesa e dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të konkurrencës.

Neni 10

Ndryshimi dhe plotësimi i Udhezimit Administrative

Ndryshimin dhe plotësimin e këtij Udhezimi Administrative mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 11

Marrëveshjet e transportit rrugore dhe hekurudhore për përjashtimet grupore ndërmjet ndërmarrësve duhet të harmonizohen plotësisht me dispozitat e këtij Udhezimi Administrativ.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrative hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(_____)

Valon Prestreshi

Kryetar

(_____)
Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

(_____)
Fatime Haziri
Anëtare

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)
Shaqir Morina
Anëtar